

Nr. Prot 268/3
Dt 16.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 1174/11 Prot.

Tiranë më 16.07.2021

LËNDA: Dërgohet miratimi i datës së konkursit për vitin akademik 2021 – 2022.

DREJTUAR: Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Referuar Urdhrit të Përbashkët QShA dhe RASh Nr. 6, datë 25.06.202, pika B., gjithashtu mbështetur dhe në Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës Nr. 25, datë 06.07.2021, miratohet data e zhvillimit të konkursit datë 26.08.2021, për vitin akademik 2021 – 2022.

Ju lutemi që një kopje e rregullores së konkursit të depozitohet në Rektorat, para datës së konkursit.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

REKTORI
Prof. Dr. Andrea MALIQARI
Maliqari
2021

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 3213 Prot.

Tiranë, më 25.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 21-183 Prot.

Tiranë, më 25.06.2021

URDHËR I PËRBASHIKËT

Nr. 6, Datë 25 / 06 / 2021

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCESIN E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E
INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR
VITIN AKADEMIK 2021 - 2022**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e kalendarit "Për procesin e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë

për vitin akademik 2021 – 2022”, sipas kalendarit, shtojcës nr.1 si dhe anekseve 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij urdhri dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtoreshë e Përgjithshme

Znj. Rezana VRAPË



Për Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtori i Përgjithshëm

Z. Artjan XHEVAJ

